

Dëshmi

Shirley Cloyes DioGuardi

Këshilltare për Çështje të Ballkanit, Liga Qytetare Shqiptaro-Amerikane

**Komisioni i Dhomës së Punëve të Jashtme
Nën Komisioni për Evropë, Euro Azi dhe Kërcënime të reja
18 Prill 2018**

“Trashëgimia e Dayton-it dhe e ardhmja e Bosnjës dhe Ballkanit Perëndimor”

Derisa Marrëveshja e Dayton-it i dha fund luftës në Bosnje në vitin 1995, ajo nuk e zgjidhi konfliktin në Ballkan. Komisioni i Dhomës për Punët e Jashtme ka bërë përpjekje serioze që të eksplorojë dhe zbulojë realitetet në terren në Evropën Juglindore gjatë okupimit dhjetë vjeçar të Kosovës dhe marshit gjenocid nëpër Ballkan nga ana e diktatorit serb Slobodan Millosheviq, i cili në fund ka marrë më tepër se 200,000 jetë dhe ka lënë katër milion qytetarë të zhvendosur. Nën presionin e komisionit juaj, Administrata e Clintonit më në fund nisi sulmet ajrore të NATO kundër Serbisë në mars të vitit 1999 duke e sjellë fundin e luftës në Kosovë, e cila filloi në vitin 1998 si një vazhdimësi e luftërave të Ballkanit të viteve 1990. Pa marrë parasysh, rrënjët e konfliktit në Ballkan kanë mbetur të pazgjidhura deri në ditën e sotme, dhe thelbi i problemit qëndron në nënshkrimin e Marrëveshjes së Dayton më 1 nëntor 1995.

Pse? Sepse i Dërguari i SHBA për Ballkan Richard Holbrooke, i cili në atë kohë ishte kryenegociatori i SHBA në Dayton, ia hodhi rolin e paqe-bërësit diktatorit serbë, dhe më vonë të akuzuarit kriminel të luftës, Slobodan Millosheviqit. Dhe në vend të një marrëveshjeje të paqes e cila kishte për të paraqitur hapat për kthimin e Bosnja-Hercegovinës në realitetin e vet të para luftës si një shoqëri me harmoni shumë etnike dhe me shumë religjione midis myslimanëve të Bosnjës, kroatëve dhe serbëve (në një nivel të cilin shumë shtete perëndimore ende duhet ta arrijnë), Daytoni ka ndarë Bosnja-Hercegovinën në dy entitete, me një qeveri federale të dobët dhe me ekonomi kombëtare në depresion. E pabesueshme, por Slobodan Millosheviqi u shpërblye me njohjen e një entitet politik të panjohur më parë të quajtur Republika Serpska. Një entitet i krijuar përmes fushatës gjenocide të Millosheviqit në Bosnje, me efektin e Dayton-it që normalizoi përdorimin e dhunës për qëllime politike. Dhe prej atëherë, kjo e la Bosnje-Hercegovinën shumë afër që të jetë e pamundur të qeveriset, sepse Sërpska e bllokoi qeverinë federale që të funksionojë në dobi të gjithë qytetarëve të Bosnjës. Kjo është arsyeja e parë pse Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian—nëse dëshirojnë që në të ardhmen mos të shohin ndonjë konflikt të armatosur—duhet të rishqyrtojnë Dayton-in dhe të krijojnë një plan të ri i cili do të sjellë paqe të qëndrueshme, harmoni ndëretnike, dhe qëndrueshmëri politike dhe ekonomike në Bosnje-Hercegovinë.

Arsyeja e dytë pse rrënjët e konfliktit në Ballkan nuk janë zgjidhur në Dayton rrallë është pranuar nga qeveritë Perëndimore dhe ekspertë të politikës së jashtme. Konkretisht, Slllobodan Millosheviqi u pajtua që të vijë në negociata vetëm nëse dy kushte plotësohen: që shqiptarëve (grupit të tretë etnik për kah madhësia në Ballkanin Perëndimor) të mos iu lejohet pjesëmarrja në tavolinë dhe që Kosova, e okupuar me forcë nga Serbia që nga viti 1989, mos të jetë pjesë e rendit të ditës. Kjo ka përgatitur terrenin për sulm ushtarak të Millosheviqit në Kosovë në vitin 1998. (Millosheviqi gjithmonë ka pasur synimin që të kryej pastrimin etnik dhe gjenocidin në Kosovë, bile përpara se trupat e tija ushtarake dhe paramilitare të pushtonin Bosnjën në vitin 1992, por Kongresisti i dikurshëm Joe DioGuardi dhe përkrahësit e tij shqiptarët e Amerikës kanë qenë në gjendje që të njoftojnë Kongresin e SHBA lidhur me planet e Millosheviqit, dhe në këtë mënyrë e vunë vëmendjen te Millosheviqi, gjë që çoi te dalja e tij e përkohshme nga Kosova.)

Për më tepër se dy dekada nga nënshkrimi i Marrëveshjes së Dayton-it, kanë dalë rrënjët e pazgjidhura të konfliktit në Ballkan, në Bosnje-Hercegovinë dhe Kosovë (dhe gjithashtu në Maqedoni). Dayton-i ka krijuar një paqe të paqëndrueshme ku shtetet dhe grupet etnike janë duke pritur për një ndërrim të madh gjeopolitik për të vazhduar konfliktin. Kjo mund të shihet qartë me lojën e dyfishtë që luan Serbia me Perëndimin, por duke e vazhduar garën me armë duke u mbështetur nga Rusia me shpresë për një konstelacion të ri të fuqive që do t'i lejonte Serbisë ta nxjerrë jashtë Republika Serpska dhe ta kthejë Kosovën. (Një shenjë i treguesit të rrezikut u dërgua Perëndimit në janar të vitit 2017, kur një tren i ngjyrosur me flamuj serbë, me skena religjioze ortodokse krishtere, dhe fjalët “Kosova është Serbi” në 20 gjuhë, u nis nga Beogradi në drejtim të veriut të Kosovës derisa nuk u ndal përpara se të ishte në gjendje që të arrinte.)

Dayton-i dhe ngjarjet në vazhdim janë ndërtuar nën premisën se Beogradi është qendra e rajonit, gjë që është burim i politikës historike të ledhatimit të Serbisë nga ana e Perëndimit. Kjo ka bërë që Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian të shpenzojnë energji të madhe gjatë njëzet viteve të fundit në demokratizimin e Serbisë, kur në fakt Beogradi është ende duke u udhëhequr nga mbetjet e autoritare të Millosheviqit që janë duke i folur fjale boshe Perëndimit dhe duke punuar ndryshe për interesa të Rusisë në rajon. Në mes gjërave tjera, Serbia ka themeluar me Rusinë të ashtuquajtur qendër humanitare në Nish, afër kufirit me Kosovën, të cilën Departamenti i Shtetit të ShBA e ka identifikuar si “një bazë ushtarake të maskuar në mënyrë delikate dhe të ngritur nga Kremli për të spiunuar interesat e SHBA në Ballkan.”

Mospërfillja e çështjes shqiptare nga Dayton-i është ende një trashëgimi shumë e gjallë, dhe problemi kryesor është ledhatimi historik i Serbisë nga ana e perëndimit. Në vend të plotësimit të oreksit ekspansionist të Serbisë, komuniteti ndërkombëtar ishte dashtë të kërkojë nga Serbia që ta njeh pavarësinë e Kosovës dhe të pranohet në Bashkimi Evropian. Për shkak se nuk ka bërë këtë, dhe për shkak se pesë anëtarë të Bashkimit Evropian ende nuk e pranan pavarësinë e Kosovës, e cila u bë realitet në vitin 2008, Beogradi u drejtua kah provokimi i dhunës në pjesën veriore të Kosovës, në zonën të cilën e ka kontrolluar dhe manipuluar financiarisht dhe

politikisht që nga koha kur Kosova erdhi nën mbrojtjen e KB me përfundimin e luftës në verë të vitit 1999.

Derisa komuniteti ndërkombëtarë ka shtyrë implementimin e “planit të Ahtisaari-t,” i cili bëri të gjitha institucionet në Kosovë shumë etnike, duke i integruar serbët e Kosovës në degët legislative, ekzekutive dhe juridike të qeverisë së Kosovës, askush asnjëherë nuk e ka testuar Ahtisarin në Veri të Kosovës, dhe kjo i ka mundësuar Serbisë që të konsolidojë kontrollin e Serbisë aty. Në fund dhe nëse Shtetet e Bashkuara nuk e ndalin marrjen e ulëses së prapme në Evropë dhe Ballkan, Serbia do të pranohet në Bashkim Evropian përmes demonstrimit të rrejshëm të “marrëdhënieve miqësore” me Kosovën (një kërkesë për pranim në BE), derisa njëkohësisht është duke e arritur atë që ishte synimi i saj primar: mohimi i sovranitetit të Kosovës dhe marrja e veriut të Kosovës. Shkurt, paqja e qëndrueshme dhe stabiliteti në rajon do të mbesin të pakapshëm. Dayton-i ka dështuar që të përmbush atë që dijetarja kroate Branka Magas ka paraparë në vitin 1999, “Nëse nuk lejohet procesi i shpërbërjes së Jugosllavisë të përfundojë dhe ish Republika e Jugosllavisë të shpërbëhet në pjesët e saja, dhe kështu të vendoset Kosova në rrugën e pavarësisë, do të jetë e pamundur që të ndërtohet një sistem shtetëror paqësor dhe demokratik në Evropën Juglindore.” (*Bosnja Raport* 1999).

Trashëgimia e Dayton-it gjithashtu përfshinë mungesën e reciprocitetit për shqiptarët në Luginën e Preshevës, ku ata janë qytetarë të rendit të dytë dhe të tretë të Serbisë, derisa serbët e Kosovës kanë nivelin më të lartë të drejtave të njeriut dhe civile nga cilido minoritet në Evropë sot. Trashëgimia e Dayton-it gjithashtu ka rezultuar me shtypje sistematike dhe diskriminim të shqiptarëve në Maqedoni.

Unë besoj, se tani është Maqedonia vendi ku qeveria e SHBA duhet të përqendrohet. Shpeshherë harrohet se, kur ish Jugosllavia u shpërbë, Republika e Maqedonisë ka dalë pa dhunë si një shtet i pavarur në vitin 1991 në bazë të bashkëpunimit të shqiptarëve etnik dhe maqedonaseve etnik. Maqedonia është shteti i vetëm në Ballkanin Perëndimor ku asnjë grup etnik nuk ka shumicë të vërtetë. Por dështimi pasues për të sjellë të drejtat e njeriut dhe civile të barabarta për të gjitha grupet etnike në Maqedoni ka çuar deri te konflikti i armatosur në vitin 2001. Për ta përfunduar konfliktin, Bashkimi Evropian dhe qeveria e SHBA kanë hyrë në negociatë me maqedonasit etnik dhe udhëheqësit politik të shqiptarëve etnik gjë që ka rezultuar me nënshkrimin e Kornizës së Marrëveshjes së Ohrit. Marrëveshja e Ohrit ishte dashur të arrinte përfaqësimin e barabartë të të gjitha grupeve kombëtare në institucionet shtetërore, dhe gjithashtu shpërndarjen e burimeve në mënyrë të barabartë. Pas shtatëmbëdhjetë viteve, dispozitat lidhur me drejtësinë, zbatimin e ligjit, ushtrinë, dhe inteligjencën, së bashku me decentralizim fiskal, janë ato që ende duhet të zbatohen.

Koha nuk do të më lejojë që të shkoj në detaje të krizës ndëretnike e cila pasoi. Por mjafton të them se kriza politike në Maqedoni nuk mund të zgjidhet shkurt me ballafaqimin me ankesat kryesore të shqiptarëve (së bashku me ankesat e jo-sllavëve tjerë). Këtu kërkohet që Maqedonia t’i përmbahet marrëveshjes, të njohur si Platforma shqiptare (të cilën jam duke ju dorëzuar për evidencë), të cilën udhëheqësit e tri partive politike shqiptare dhe udhëheqësi i partisë Social

Demokrate të maqedonasve etnik Zoran Zaev kanë përdorë për krijimin e qeverisë së re në vitin 2017. Platforma shqiptare përmban shumicën prej pesëmbëdhjetë dispozitave të cilat ishin pjesë e Kornizës së Marrëveshjes së Ohrit 2001.

Edhe një herë, arritja e barazisë etnike është e rrezikuar në Maqedoni. Në janar të vitit 2018, Kuvendi i Maqedonisë ka miratuar dy herë ligjin duke e bërë shqipen gjuhë të dytë zyrtare të shtetit, që ka qenë obliguese me marrëveshjen në mes të partisë SDSM të Zoran Zaev-it dhe partive politike shqiptare. Megjithatë, Presidenti i Maqedonisë Gjorgje Ivanov ka vendosur veton dy herë duke pretenduar se një gjuhë e dytë zyrtare do ta kërcënonte “unitetin, sovranitetin dhe integritetin territorial.” të Maqedonisë. Kushtetuta e Maqedonisë kërkon miratimin e këtij ligji nga ana e kuvendit pas dy votimeve në favor, por kjo ende nuk ka ndodhur.

Komponenti i dytë më i rëndësishëm i Platformës shqiptare është decentralizimi i buxhetit federativ. Ndalja e diskriminimit të shqiptarëve etnik duke ofruar mundësi të barabartë për rritje ekonomike dhe sociale në zonat ku shqiptarët janë shumicë etnike mund të zvogëlojë dukshëm mundësinë për konflikt të armatosur në të ardhmen. Pyetja mbetet se a do të marrin iniciativën e negociimit Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian për të caktuar një afat kohor për arritjen e barazisë së plotë të komuniteteve maqedonase dhe shqiptare në Maqedoni përpara se vendi të pranohet në NATO. Posaçërisht në Maqedoni, ne kemi qenë dëshmitarë të qasjes së politikës së jashtme nga qeveria e SHBA gjatë njëzet viteve të fundit që ishte e fokusuar në stabilitet me çdo çmim, në vend se parandalimi i konfliktit dhe të drejtat e njeriut të jenë në qendër të angazhimit tonë në rajon. Prandaj, pas-Daytonit, konflikti në Ballkan është i pazgjidhur.

Për aq kohë sa shqiptarëve iu mohohet njohja e cila është bërë për çdo shumicë tjetër etnike në ish Jugosllavi, dhe për aq kohë sa nuk ka ndryshim në status quo nga politika e jashtme e perëndimit, konflikti në Ballkan nuk do të zgjidhet. Rruga përpara duhet të përfshin bërjen e të drejtave të njeriut, anti- racizmin, dhe sundimin e ligjit një pikë kyçe të përfshirjes së SHBA dhe BE në Evropën Juglindore. Dhe kështu koha ka ardhur që të pyeten qeveria e SHBA dhe Bashkimi Evropian se çka vërtetë dëshirojnë. A e dëshirojnë një Bashkim Evropian të tërë, të pandarë, paqësor, demokratik dhe me prosperitet, apo një periferi të dështuar të shoqërive të varura nga ndihmat që e ngarkojnë atë me përgjegjësitë ekonomike dhe zbatim të ligjit? Që të parandalohet një konflikt i shtrenjtë dhe potencialisht vdekjeprurës në vazhdim, Perëndimi do të duhet të mendojë sërish për strategjinë diplomatike të vet dhe politikën e jashtme në Ballkan, me shpresë se do të theksojë parandalimin e konfliktit dhe të drejtat e njeriut, e jo stabilitetin me çdo çmim.